



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 5234 Prot., Datë 01.09.2023

PROKURORIA E POSAÇME

Nr. 552 Prot., Datë 01.09.2023

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 534, datë 01.09.2023

PËR

NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MARRJEN NË DORËZIM TË PASURISË
NR. 8/123, NË ZONËN KADASTRALE 8330

Në mbështetje nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe vendimit nr.378, datë 21.06.2023 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë "Ujësjellës - Kanalizimeve Tiranë" sh.a, të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330", ministri i Drejtësisë dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Grupit të Punës me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për marrjen në dorëzim të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330.
2. Grupi i punës përbëhet nga
 - a. përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë si më poshtë:
 - i. Gojart Laçi, me detyrë Specialist
 - ii. Entela Muho, me detyrë Specialiste
 - b. përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si më poshtë:
 - i. Laureta Binaj me detyrë Kancelare.
 - ii. Armand Shini me detyrë Drejtor i Drejtorisë Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.


- iii. Julinda Mansaku me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse,
- iv. Artir Pashollari me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit
- v. Eduart Danaj me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve.

3. Detyrat e grupit të punës janë si më poshtë:

- a) marrja në dorëzim e pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.
 - b) regjistrimi i saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme si dhe në listën e inventarit të aseteve;
 - c) koordinim i punës ndërmjet institucioneve për ndjekjen e procedurave të nevojshme sipas këtij urdhri;
 - ç) kryerja e çdo detyre tjetër në përmbushje të qëllimit të këtij urdhri.
4. Procesi i kalimit të kryhet në përputhje me vendimin nr.378, datë 21.06.2023 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë "Ujësjellës - kanalizimeve Tiranë" sha, të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330" dhe në çdo rast përdorimi i pronës kryhet në përputhje me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
5. Anëtarët e grupit të punës së Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me pikën 2 të vendimit nr.378, datë 21.06.2023 të Këshillit të Ministrave, do të asistojnë gjatë procesit të kalimit në përdorim të pronës së sipërpërmendur.
6. Në momentin e përfundimit të procedurave grupi i përbashkët i punës të hartojnë një raport të hollësishëm mbi detyrat e kryera në përputhje me pikën 3 të këtij urdhri.
7. Grupi i punës përfundon punën brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe paraqet raportin pranë ministrit të Drejtësisë dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË


 Ulsi Manja


DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME
 KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT
 TË ORGANIZUAR


 Altin Dumani
